



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*  
*Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance*

# RAPORTI VJETOR



**PËR KONSULTIMET ME PUBLIKUN NË QEVERINË  
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2019**

Përmbajtja

<b>Lista e shkurtesave.....</b>	<b>4</b>
<b>1. Hyrje .....</b>	<b>5</b>
<b>2. Përmbledhje Ekzekutive.....</b>	<b>7</b>
<b>4. Platforma online për konsultime publike .....</b>	<b>10</b>
<b>5. Bashkëpunimi dhe ngritja e kapaciteteve për konsultimet publike .....</b>	<b>10</b>
<b>6. Koordinimi dhe mbarëvajtja e procesit të konsultimeve në kuadër të institucioneve .....</b>	<b>12</b>
<b>7. Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve .....</b>	<b>13</b>
<b>8. Shkalla e plotësimit të standardeve minimale .....</b>	<b>14</b>
<b>9. Plotësimi kritereve të treguesit të SBS-së.....</b>	<b>16</b>
<b>10. Metodat e përdorura gjatë procesit të konsultimeve.....</b>	<b>18</b>
<b>11. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në proces të konsultimeve.....</b>	<b>20</b>
<b>12. Numri dhe statusi i komenteve.....</b>	<b>21</b>
<b>13. Statistikat krahasuese mes viteve 2017, 2018 dhe 2019 .....</b>	<b>24</b>
<b>14. Përfundimet dhe sfidat .....</b>	<b>26</b>
<b>SHTOJCA I: Lista e dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2019.....</b>	<b>27</b>

## **Lista e Figurave**

Figura 1: Cilat departamente janë të përfshirë në zbatimin e konsultimeve publike? .....	12
Figura 2: Shkalla e plotësimi te SBS (me vendime).....	17
Figura 3: Shkalla e plotësimi të standardeve të SBS (pa vendime të Qeverisë) .....	18
Figura 4: Numri i dokumenteve te konsultuara (2019).....	13
Figura 5; Numri i dokumenteve sipas kategorive (2019) .....	13
Figura 6: Shkalla e plotësimi te standardeve .....	14
Figura 7: Plotësimi i standardeve sipas ministrive (2019) .....	15
Figura 8: Cilat metoda të konsultimit i konsideroni më të dobishme? .....	20
Figura 9: Si i informoni palët e interesuara për konsultimet që hapen nga ministria e juaj? .....	21
Figura 10: Numri dhe statusi komenteve (2019).....	22
Figura 11: Ndarja e dokumenteve sipas komenteve ne platforme .....	22
Figura 12: Komentet sipas ministrive .....	23
Figura 13: Dokumente te konsultuara, pjesmarres dhe komente .....	24
Figura 14: Informatat krahasuese 2017-2018-2019 .....	25

## **Lista e Tabelave**

Tabela 1: Përlllogaritja e treguesve të përkrahjes buxhetore sektoriale nga BE. Kategoria e parë e vlerësimit .....	16
Tabela 2: Përlllogaritja e treguesve të përkrahjes buxhetore sektoriale nga BE. Kategoria e dytë e vlerësimit .....	17
Tabela 3: Metodatat e konsultimit të përdorura sipas ministrive .....	19

## Lista e shkurtesave

ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
DIEKP	Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
KE	Komisioni Evropian
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MeD	Ministria e Diasporës
MF	Ministria e Financave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIE	Ministria e Integriteteve
MIN	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
MKK	Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
ReSPA	Shkolla Rajonale për Administratë Publike
RCC	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
SBS	Mbështetje Buxhetore Sektoriale (Sector Budget Support)

## 1. Hyrje

Transparenca është një nga faktorët kryesorë që ndikon në rritjen e llogaridhënies e si rezultat edhe në rritjen e performancës së administratës publike. Sistemi aktual i konsultimeve publike i themeluar në vitin 2016, tashmë është futur në një fazë stabiliteti të procesit të politikë bërjes dhe hartimit të legjislacionit në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Proces ky i udhëhequr dhe koordinuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit e i përkrahur nga koordinаторët për konsultimet me publikun në Zyrën e Kryeministrit dhe në ministritë e linjës. Prandja si rrjedhojë edhe plotësimi i standardeve të përcaktuara me Rregulloren nr.05/2016 për standardet minimale për konsultime me publikun tashmë është bërë pjesë e punës së përditëshme të institucioneve publike.

Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të standardeve të konsultimit publik, avancimi i procesit dhe zhvillimi i platformës online të konsultimeve me publikun është bërë pjesë e punës së përditëshme të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit por edhe ministrive përmes koordinatoreve për konsultime dhe përgjegjësve tjerë të këtij procesi. Gjithashtu monitorimi i zbatimit procesit të konsultimeve është bërë pjesë e Strategjisë për bashkëpunim mes Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, si dhe pjesë e vlerësimit të Komisionit Evropian përmes marrëveshjes së Qeverisë dhe Komisionit Evropian për mbështetjen buxhetore.

Përveç shtrirjes në nivel qendror të qeverisë, sistemi i konsultimeve publike është zgjeruar edhe në të gjitha komunat si në aspektin rregullator ashtu edhe në krijimin e mjeteve dhe kushteve për zbatimin e tij. Mirëpo duhet theksuar se niveli lokal nuk është pjesë e fushëveprimit të këtij raporti.

Vlerësohet se edhe gjatë vitit 2019 progresi në plotësimin e standardeve minimale të konsultimeve publike ka shënuar trende pozitive të cilat janë vlerësuar lartë nga të gjitha institucionet vendore e të huaja. Megjithëse edhe pas këtij viti mbesin ende sfidat të cilat duhet të merremi. Vitin 2019 e kanë përcjellë edhe sfida të shkaktuara nga faktorë të cilët nuk hyjnë në kuadër të sistemit të konsultimeve publike, veçanërisht duhet të përmendet fakti i funksionimit të kufizuar të qeverisë gjatë vitit 2019 për shkak të dorëheqjes së saj në korrik 2019.

Gjatë vitit 2019 në plotësimin e standardeve të konsultimeve janë shënuar rezultatet në vijim:

- Ngritje e përqindjes së dokumenteve të hartuara që i janë nënshtruar procesit të konsultimit në 100%.
- Rritje e numrit të dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2019 në 274 nga 228 sa ishin konsultuar në vitin 2018.
- Rritje të shkallës së plotësimin të standardeve të procesit të konsultimit në 82% për standardet e SBS dhe në 67% për të gjitha dokumentet në vitin 2019.
- Është rritur numri i pjesëmarrësve në proces të konsultimeve publike në më shumë se dyfish në krahasim me vitin 2018.

- Anketa e mbajtur me koordinatorët e konsultimeve publike në ministri gjatë hartimit të këtij raporti nxjerrë se shumica e ministrive janë të kënaqura nga procesi i konsultimeve publike. Gjithashtu anketa rezulton se procesi i konsultimeve ka pasur efekte pozitive, sidomos në transparencë dhe llogaridhënie, informim të palëve të interesit për procesin e hartimit dhe përmbajtjen e politikave dhe legjislacionit të hartuar nga ministrinë si dhe dhënien e mundësisë palëve të interesit për të dhënë kontributin e tyre.
- Është forcuar bashkëpunimin më koordinatorët për standardet minimale të ministrive, me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit dhe përgjegjësit tjerë për zhvillimin e konsultimeve publike.
- Përveç mbajtjes së trajnimeve dhe punëtorive me koordinatorët e konsultimeve publike gjithashtu janë mbajtur edhe trajnimet në vend të punës në ministri të caktuara për të siguruar edhe pjesëmarrjen e strukturave tjera të ministrive, veçanërisht departamenteve për hartim të politikave.
- Është bërë avancimi i platformës elektronike për konsultimet publike ku tani disa kategori të statistikave mund të gjenerohen automatikisht nga ana e administrueseve (koordinatorëve) të platformës dhe platformës i është shtuar moduli i konsultimeve në nivel të komunave.
- Ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe palët e interesit për rritjen e interesit të tyre për të kontribuar në konsultime kualitative.

## 2. Përmbledhje Ekzekutive

Pas miratimit të Rregullores Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimeve publike (më tutje Rregullores)<sup>1</sup> ky është raporti i tretë vjetor që paraqet progresin për këtë proces. Raporti ka qëllim të paraqesë punën e bërë gjatë vitit 2019 në zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike nga ana e Qeverisë, të udhëhequr nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera të përfshira në procesin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit.

Raporti paraqet detajet dhe statistikat për plotësimin e të gjitha standardet që nga hartimi apo inicimi i procesit të konsultimit, hartimit të dokumentit të konsultimit, përdorimit të metodave të konsultimit, përfshirë edhe platformën, pjesëmarrjen e publikut në ofrimin e kontributeve të tyre, statusin e komenteve etj. Informata të ndara janë ofruar për shkallën e plotësimit të standardeve të përcaktuara me treguesin e Marrëveshjen e Mbështetjes Buxhetore mes Qeverisë dhe Komisionit Evropian.

Raporti paraqet në mënyrë të detajuar kategoritë e informatave si në vijim:

- **Numri i përgjithshëm i dokumenteve të hartuara dhe të konsultuara** - Gjatë vitit 2019 gjithsej raportohet se janë hartuar 274 dokumente nga të gjitha ministrinë të cilat sipas standardeve minimale do të duhej ti nënshtroheshin procesit të konsultimit publik. Nga ky numër i përgjithshëm, konsultimit publik i janë nënshtuar 100% apo të gjitha këto dokumente. 274 dokumente (272 përmes platformës ndërsa 2 dokumente janë konsultuar jashtë platformës), nga to 15 koncept dokumente, 31 projekt ligje, 77 projekt rregullore, 129 projekt udhëzime administrative, 6 strategji, 5 programe, 7 plane të veprimit dhe 8 dokumente tjera. Të gjitha ministrinë (përveç MKK-së) kanë hartuar dhe konsultuar dokumente publike.
- **Plotësimi i standardeve** - Vlerësohet se 183 dokumente apo 67 % e dokumenteve të konsultuara i kanë plotësuar standardet minimale të cilat janë paraparë më rregullore ndërsa 91 apo 33% të tyre nuk i kanë plotësuar këto standardet.
- **Plotësimi kriterëve të treguesit të SBS-së** - Në kuadër të kornizës së kushteve të treguesit të SBS-it gjatë vitit 2019 janë konsultuar gjithsej 57 dokumente. Vlerësimi bëhet për dokumentet që janë konsultuar gjatë kohës para dorëheqjes së Kryeministrit më 19 korrik ku shkalla e plotësimit është 51% (marrë parasysh edhe vendimet e Qeverisë për dokumentet e konsultuara) dhe kategoria e dytë ku hyjnë të gjitha dokumentet e konsultuara gjatë vitit 2019 që hyjnë vlerësim të SBS. Shkalla e realizimit të kësaj kategorie arrin në shkallën 82% (pa përfshirë vendimet e Qeverisë për dokumentet e konsultuara).

---

<sup>1</sup> Rregullore (QRK) Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, është miratuar në mbledhjen e 86 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.06/86, datë 29.04.2016.

- **Pjesëmarrja në proces të konsultimit dhe komentet** - Është raportuar se gjatë procesit të konsultimeve publike gjithsejtë kanë marrë pjesë 3577 pjesëmarrës të cilët kanë bërë 1339 komente qoftë përmes takimeve, grupeve të punës apo edhe me shkrim. Llogaritet se 688 ose 61% e tyre janë pranuar nga institucionet hartuese, 97 apo 7.2% prej tyre janë pranuar pjesërisht ndërsa 543 komente apo 4.50% janë refuzuar, ndërsa për 6 komente nuk ka informata nëse janë pranuar apo refuzuar.
- **Metodat e përdorura të konsultimit** - Të gjitha dokumentet e konsultuara gjatë vitit 2019 janë publikuar në platformë. Përveç publikimit në platformë, 103 dokumente (apo 37 % të numrit të përgjithshëm të dokumenteve të konsultuara) janë konsultuar edhe përmes punëtorive, ndërsa 99 dokumente apo 36% janë konsultuar përmes e-mailit. Përveç kësaj gjithashtu 35 dokumente apo 12.6% janë konsultuar edhe përmes takimeve publike, 24 dokumente apo 8.6 % janë konsultuar edhe përmes takimit sy më sy dhe 21 dokumente po 7.6% janë konsultuar përmes takimeve me grupe të interesit.
- **Sfidat dhe rekomandimet** – Përveç vlerësimeve dhe përvojës së Zyrës së Kryeministrit, përvojat e tyre për sfidat dhe rekomandimet i kanë paraqitur edhe koordinаторët e konsultimeve publike në ministri përmes anketës së zhvilluar me ta gjatë hartimit të këtij raporti. Përveç sfidave raporti në pjesën përfundimtare paraqet edhe rekomandimet të cilat duhet të ndërmerren në të ardhmen për përmirësimin e procesit të konsultimeve dhe kualitetit të tyre.

### 3. Metodologjia e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve

Raportimi vjetor është bërë sipas metodologjisë së raportimit të zhvilluar dhe miratuar ne vitin 2017. Ekzistojnë disa burime të informatave për hartimin e këtij raporti.

- Informatat e dërguara nga koordinatorët e konsultimeve publike nga secila ministri dhe Zyra e Kryeministrit.
- Informatat e publikuara dhe të gjeneruara nga platforma e konsultimeve publike.
- Informatat të cilat rrjedhin nga aktivitetet e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit dhe projekteve të cilat e mbështesin Qeverinë në zhvillimin dhe avancimin e konsultimeve publike, në veçanti Asistencës Teknike të Komisionit Evropian “Mbështetje për zbatimin e Strategjisë për Bashkëpunim mes Qeverisë dhe Shoqërisë Civile”.

Kërkesës së Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit për raportim nga ana e ministrive të dërguar me datë 22 janar 2020 i ka paraprirë një punëtori njëditore e mbajtur me koordinatorët e ministrive për konsultime publike me datën 21 janar 2020.

Raportimi nga koordinatorët është bërë përmes formularëve të dizajnuar për mbledhjen e informatave për hartimin e raportit vjetor sipas Rregullores dhe Metodologjisë së Monitorimit dhe Raportimit për zbatimin e standardeve minimale të miratuar nga ZKM në vitin 2017.



Kërkesës së ZQM/ZKM-së për raport vjetor ju kanë përgjigjur të gjitha ministrinë përveç MPMS-së, MKRS-së, MeD, ndërsa MKK nuk ka hartuar ndonjë dokument për të cilin është dashur të konsultohet e raportohet. Për ministrinë të cilat nuk ju kanë përgjigjur kërkesës për raportim ZQM/ZKM është bazuar në informatat të cilat kanë qenë në dispozicion në platformën e konsultimeve për dokumentet të cilat kanë konsultuar ato ministri.

Vlen të theksohet se për Zyrën për Qeverisje të Mirë, Projekti i Asistencës Teknike i BE-së gjithashtu ka ofruar mbështetje në hartimin apo mbledhjen e kontributeve për hartimin e raportit. Seanca janë mbajtur me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa mbështetje gjithashtu është ofruar për Ministrinë e Drejtësisë.

Gjithashtu pasi disa nga informatat e raportuara nga ministrinë nuk janë përputhur me ato që gjenden në platformë si dhe ministrinë që përmendën më lartë nuk kanë raportuar fare, atëherë informatat plotësuese janë marrë nga platforma elektronike për konsultimet publike.

Kriteret e vlerësimit sipas Rregullores për standardet minimale janë:

- Secili dokument i konsultuar duhet të ketë planin e konsultimit.
- Dokumenti i konsultimit së bashku më dokumentin themelor i cili konsultohet duhet të jetë i publikuar në platformën elektronike për konsultimet publike.
- Afati i konsultimit duhet të jetë së paku 15 ditë punë.
- Raporti i konsultimit duhet të jetë i publikuar në platformë për secilin dokument të konsultuar.
- Dokumenti themelor i konsultimit të jetë i publikuar pas përfshirjes së komenteve dhe propozimeve.

Por për të ofruar dimensionin kualitativ në raportin vjetor të konsultimeve publike të mbajtura gjatë vitit 2019 është zhvilluar edhe një anketë me koordinorët e konsultimeve publike. Informatat e siguruar nga anketa janë përfshirë në raportin vjetor për konsultimet publike në mënyrë komplementare dhe në kuadër të strukturës ekzistuese të raportit vjetor të hartuar sipas metodologjisë së raportimit. Në fokus të pyetësorit kanë qenë koordinorët e konsultimeve publike në ministri dhe në Zyrën e Kryeministrit. Nga gjithsejtë 21 ministri dhe Zyra e Kryeministrit janë plotësuar 14 pyetësorë nga ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit të cilët kanë qenë pjesëmarrës në punëtorinë e organizuar me 21 janar 2020 me Koordinatorët e Konsultimeve Publike.

Për vlerësimin e treguesve sipas kontratës së SBS-it përfshihen vetëm koncept dokumentet, projekt ligjet dhe dokumentet strategjike, për dallim nga vlerësimi i përgjithshëm i standardeve sipas rregullores kur përfshihen edhe aktet nënligjore dhe dokumente tjera. Gjithashtu për dallim nga vlerësimi i përgjithshëm, për arritjen treguesit të SBS, në vlerësim do të duhet të përfshihen vetëm dokumentet për të cilat qeveria gjithashtu ka marrë vendim deri në momentin e hartimit të këtij raporti. Por miratimi i dokumenteve nga Qeveria si kriter i treguesit të SBS-it në këtë raport nuk është llogaritur pasi që Qeveria në detyrë nga muaji gusht kur është dorëhequr nuk ka pasur përgjegjësi për miratimin e legjislacionit primar.

#### **4. Platforma online për konsultime publike**

Gjatë vitit 2019 në platformën elektronike është punuar në dy drejtime.

1. Në përmirësimin e defekteve teknike të cilat janë hasur gjatë përdorimit të saj nga ana institucioneve dhe përdoruesve tjerë, dhe
2. Në zgjerimin e platformës me elemente të reja të cilat nuk kanë ekzistuar më herët.

Për shkak të ndërtimit të sistemit të konsultimeve publike edhe në nivelin lokal dhe për të akomoduar kërkesat për përfshirjen e komunave në proces të konsultimit, në platformë gjatë vitit 2019 janë shtuar modulet e reja për secilën komunë, si dhe është ndërtuar sistemi i gjenerimit të statistikave për nivel lokal.

Sa i përket perceptimit dhe vlerësimit të koordinatorëve për funksionimin e Platformës elektronike, në anketën e zhvilluar me koordinatorët në pyetjen se “*Çfarë dëshironi të ndryshoni në funksionimin e platformës elektronike?*” përgjigjet janë dhënë si në vijim:

- Të mos lejohet të bëhet ndryshimi i datës fillestare për konsultimet publike.
- Rritja e kapacitetit dhe saktësia e pranimin të dokumenteve
- Sistemi të jetë më i shpejt dhe funksional pasi në shumicën e rasteve është i pamundur publikimi.
- Të caktohet struktura e përhershme e platformës.

Ndërsa shumica e respondentëve në këtë pyetje janë shprehur të kënaqur me funksionimin e platformës.

#### **5. Bashkëpunimi dhe ngritja e kapaciteteve për konsultimet publike**

Gjatë vitit 2019 kanë vazhduar bashkëpunimi me ministrinë dhe shoqërinë civile sa i përket mbarëvajtjes dhe përmirësimit të procesit të konsultimeve publike.

Ministrive ju është ofruar mbështetje e vazhdueshme nga ana e Zyrës për Qeverisje të Mirë përmes informatave të përditshme, përgjigje dhe sqarime siç është kërkuar nga ministrinë. Me mbështetjen e Projektit të Komisionit Evropian, trajnime të vendin e punë i është ofruar Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Seanca e trajnimit në vendin e punës për këtë ministri është ofruar me datë: 26 nëntor 2019 dhe në të cilën kanë marrë pjesë 13 pjesëmarrës nga menaxhimet dhe stafi i ministrisë.

Përveç mbështetjes për zhvillim të konsultimeve, ministrive ju është ofruar mbështetje në hartimin apo mbledhjen e kontributeve për hartimin e Raportit Vjetor të Konsultimeve për vitin 2019. Seanca janë mbajtur me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa mbështetje gjithashtu është ofruar për Ministrinë e Drejtësisë.

Duke ndjekur këto nevoja, duke u bazuar në suksesin e aktiviteteve të mëparshme të trajnimeve, si dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i standardeve minimale për konsultime publike gjatë viteve të fundit Zyra e Kryeministrit /ZQM, në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administrata Publike, me mbështetjen e projektit të BE-së "Mbështetje për Zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile" kanë planifikuar dhe e kanë ofruar Programin e trajnimit të trajnerëve (ToT), program që synon të krijojë një grup trajnues që në të ardhmen do të jenë në gjendje të ofrojë për konsultimet publike për institucionet. Në këtë mënyrë, do të sigurohet qëndrueshmëria e aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve të ndërmarra vitet e kaluara me mbështetjen e projektit të asistencës teknike të BE-së. Për më tepër, zbatimi i programit ToT do të japë shtysë shtesë në përmbushjen e indikatorëve të Ndihmës Sektoriale Buxhetore për administratën publike në Kosovë. Gjatë vitit 2019, janë kryer të gjitha përgatitjet për finalizimin e procesit të Trajnimit të Trajnerëve, si hartimi i programit të trajnimit, përgatitja e thirrjes publike, finalizimi i thirrjes publike dhe publikimi i saj. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve është përfunduar ndërsa trajnimi po ashtu është realizuar gjatë muajit mars 2020.

Zyra për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Monitorimit të Strategjisë për bashkëpunim mes Qeverisë dhe Shoqërisë civile ka mbajtur takime të rregullta, ku gjithashtu temë diskutimi dhe monitorimi është procesi i konsultimit publik dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e politikë bërjes.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bashkë me IKAP-in, ka zhvilluar trajnimin në fushën Administrate dhe Legjislacion më temën "Procesin i konsultimit me publikun "me dy grupe të pjesëmarrësve. Grupi i parë me 02-03 prill 2019, dhe grupi i dyte me 15 -16 prill 2019. Qëllimi i organizimit të trajnimeve ka pasur target zyrtarët përgjegjëse për hartimin e legjislacionit dhe politikave në ministritë e linjës. Numri i zyrtarëve që kanë qenë pjesë në këto dy raunde trajnimi ku kanë qenë: 32 pjesëmarrës për grupin e parë dhe 24 për grupin e dytë. Gjithashtu ZQM/ZKM bashkë me IKAP-in dhe MAPL me 09 dhe 10 shtator 2019 kanë realizuar rundin tjetër të trajnimeve - Procesi i konsultimit publik në nivel lokal, ku pjesë e tij kanë qenë pesë komuna me nga 06 zyrtarë publik.

Megjithatë nevoja për rritjen e bashkëpunimit dhe mbështetjes për ministritë në ngritjen e kapaciteteve për procesin e konsultimeve publike është ende e madhe. Kërkesa për trajnime dhe bashkëpunim më të mirë është shprehur nga ana e koordinatorëve të ministrive edhe përmes anketës së zhvilluar me ta gjatë janarit 2020. Në pyetjen "*Çfarë kapacitetesh/aftësish ju nevojitet të ngriseni më tutje në institucionin tuaj?*" përgjigjet e koordinatorëve janë si në vijim:

- Trajnime dhe ndihmë profesionale është kërkuar nga 6 (apo 60%) nga 10 përgjigjet e marra nga respondentet në këtë pyetje.
- Mbështetje në koordinim dhe ofrim të informatave.
- Mbështetje buxhetore për takime me publikun,
- Mbështetje në hartimin e planit të konsultimit etj.

Përgjigje të ngjashme janë dhënë edhe në pyetjen se "*Çfarë lloj mbështetje ju nevojitet nga niveli qendror/Zyra e Kryeministrit?*" ku përveç mbështetjes së kërkuar kërkohet gjithashtu të bëhet trysni tek hierarkia për respektimi e rregullores për standardet minimale për procesin e

konsultimeve publike por edhe ndihmë në evitimin e paqartësive për procesin e konsultimeve publike.


## 6. Koordinimi dhe mbarëvajtja e procesit të konsultimeve në kuadër të institucioneve

Koordinimi dhe bashkëpunimi i brendshëm në kuadër të ministrive shihet si një nga sfidat kryesore sa i përket mbarëvajtjes së procesit të konsultimeve publike.

Shqetësim sa i përket mungesës së koordinimit brenda institucional në ministri është shprehur në vazhdimësi nga ana e koordinatorëve. Ndërsa ky shqetësim është shprehur edhe në përgjigjet e anketës në pyetjen “Cilat janë sfidat kryesore që ministria juaj përballet gjatë kryerjes së konsultimeve publike?”. Respondentet theksojnë se nuk e kanë përkrahjen mjaftueshëm nga ana e ministrive dhe kanë vështirësitë në sigurimin e dokumenteve të konsultimit dhe raportit të konsultimit nga ana e hartuesve e sponsorëve të tyre.

Vështirësitë në koordinim dhe përfshirje direkte të departamenteve që janë përgjegjës për hartimin e politikave dhe hartimin e dokumenteve vërehen edhe nga përgjigjet në pyetjen “Cilat departamente janë të përfshirë në zbatimin e konsultimeve publike?”

Figure 1: Cilat departamente janë të përfshirë në zbatimin e konsultimeve publike?



Siç shihet në përgjigjet e koordinatorëve në vetëm 7 apo 50% përgjigjeve përfshihet departamenti përgjegjës për hartimin e politikave në proces të konsultimit të dokumentit përkatës. (figura 1). Ndërsa në shumicën e rasteve kontribuues të procesit të konsultimit janë Departamentet ligjore dhe Departamentet për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave.

## 7. Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019 Qeveria e Republikës së Kosovës ka finalizuar konsultimin për 274 dokumente të cilat hyjnë në kategorinë e dokumenteve që sipas Rregullores hartuesit të tyre e kanë për obligim ti konsultojnë me publikun (figura 4).

Figure 2: Numri i dokumenteve te konsultuara (2019)



Nga këto dokumente 272 kanë qenë të publikuara në platformën e konsultimeve ndërsa dy dokumente janë konsultuar vetëm përmes metodave tjera të konsultimit. Në krahasim me vitin paraprak (2018) gjatë vitit 2019 janë konsultuar 18% më shumë dokumente.

Figura 3: Numri i dokumenteve sipas kategorive (2019)




Numri më i madh i dokumenteve të cilat janë hartuar gjatë vitit 2019 i përkasin kategorisë së akteve nënligjore, ku prijnë projekt udhëzimet administrative (129 udhëzime administrative) pastaj projekt rregulloret (gjithsej 77 projekt rregullore) dhe 31 projekt ligje, pastaj 15 koncept dokumente strategjike, 6 strategji, 5 programe, 7 plane të veprimit dhe 4 dokumente tjera kanë kaluar në proces të konsultimit publik (Figura 5).

## 8. Shkalla e plotësimit të standardeve minimale


Numri i dokumenteve të cilat i janë nënshtruar konsultimit më publikun është 100%. Plotësimi i standardeve minimale të procesit të konsultimeve publike shprehur në përqindje gjatë vitit 2019 është 67%. Shkalla e plotësimit të standardeve minimale i paraqitur në këtë raport bazohet në informatat e dërguara nga ana e koordinatorëve të ministrive, por edhe nga platforma elektronike për konsultime publike. Vlerësohet se nga numri i përgjithshëm i dokumenteve të konsultuara (274 dokumente), standardet minimale të parapara me rregullore i plotësojnë gjithsej 183 apo 67% ndërsa numri i dokumenteve të cilat nuk kanë plotësuar të gjitha standardet minimale janë gjithsej 91 dokumente apo 33% (figura 6). Ndër standardet që në shumicën e dokumenteve nuk përmbushen është mungesa e publikimit të raportit të konsultimit. Gjithashtu shumë dokumente nuk e kanë të publikuar dokumentin e konsultimit apo nuk e respektojnë kohëzgjatjen e konsultimit prej 15 ditë pune ashtu siç kërkohet shprehimisht me rregullore.

Figure 4: Shkalla e plotësimit të standardeve



- **Ministritë të cilat kanë plotësuar standardet** plotësisht janë: MM në 22 dokumente, MF me 19 dokumentet e konsultuara, MPJ me katër dokumente, MD me 20 dokumente, MTI me 21 dokumente, ZKM me 11 dokumente të konsultuara, MIE dhe MZHR kanë konsultuar vetëm nga një dokument (figura 7).
- **Ministritë që kanë plotësuar standardet mbi 75%:** MZHE nga 25 dokumente vetëm me 2 nuk ia ka plotësuar standardet, pastaj MSH nga 12 dokumente vetëm një dokument nuk i kanë plotësuar standardet.
- **Ministritë që kanë plotësuar standardet mes 50-75% janë:** MMPH nga 28 dokumente në 20 i kanë plotësuar standardet ndërsa në 8 nuk i kanë plotësuar, ndërsa MASHT nga 28 dokumente për 18 dokumente nuk i kanë plotësuar standardet, MAPL nga 5 dokumente me 3 i kanë plotësuar standardet.
- **Ministritë që kanë plotësuar standardet nën 50% janë:** MAP nga 21 dokumente vetëm 3 i kanë plotësuar standardet, MPMS nga 10 dokumente vetëm për një i plotëson standardet, MBPZHR nga 9 dokumente, me tri dokumente i plotëson standardet, MPB me 24 dokumente, dy i plotësojnë standardet.
- **Ministritë që nuk asnjë dokument nuk plotëson të gjitha standardet hyjnë:** MKRS me 8 dokumente, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit me 2 dokumente , MeD me 2 dokumente dhe MIN me një dokument të konsultuar gjatë vitit 2019 (shih figura 7 më poshtë).

Figure 5: Plotësimi i standardevë sipas ministrive (2019)



## 9. Plotësimi kritereve të treguesit të SBS-së

Përveç raportimit për zbatimin e rregullores për standardet minimale Zyra për Qeverisje të Mirë monitoron zbatimin e standardeve minimale që kanë për qëllim matjen e indikatorit II “Komunikimi efektiv publik, konsultimi publik dhe pjesëmarrja e palëve të interesuara” i sipas Marrëveshjes për Përkrahje Direkte Buxhetore (SBS) në kuadër të IPA 2 e cila marrëveshje ofron përkrahje buxhetore në vlerë prej 25 milion euro për Kosovën. Indikatorit i konsultimeve publike në SBS, gjatë vitit 2019 synon konsultimin e së paku 70% të projekt strategjive/politikave sektoriale/koncept dokumenteve dhe ligjeve primare, të cilat janë miratuar nga qeveria në vitin 2019, në përputhje standardet e përcaktuara, dhe për vitin 2020 plotësimi standardeve duhet të jetë në shkallën 90%.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit monitoron dhe raporton mbi zbatimin e Rregullores për Standardet Minimale të Konsultimit Publik. Tri zyra përgjegjëse (ZPS/ZKM, ZL/ZKM dhe SKQ/ZKM) do të sigurojnë që kërkesat e konsultimit publik të zbatohen në përputhje me zotimet e përcaktuara në Pasaportën e treguesve për Strategjinë për Rregullim më të Mirë. ZKM do të raportojë për konsultimet për strategjitë/programet, koncept dokumentet dhe ligjet dhe ky informacion do të shpërndalet drejtpërsëdrejti me BE-në për qëllime të raportimit.

Për shkak të situatës së krijuar pas dorëheqjes së Kryeministrit me datë 19 korrik 2019 Zyra për Qeverisje të Mirë bën vlerësimin dokumenteve të konsultuara sipas dy kategorive të kritereve:

**1. Në kategorinë e parë** janë dokumentet të cilat hyjnë në vlerësim të plotësimit të të gjitha standardeve të përcaktuara me marrëveshje të SBS. Në këtë grup përfshihen të gjitha dokumentet për të cilat është mbyllur konsultimi mes datave 1 janar 2019 dhe 19 korrik 2019. Këtu përfshihen edhe disa dokumente të plotësuara më vonë dhe të cilat janë miratuar në Qeveri<sup>2</sup>.

Tabela 1: Përlllogaritja e treguesve të përkrahjes buxhetore sektoriale nga BE. Kategoria e parë e vlerësimit

PERLLOGARITJA E TREGUESVE TE PERKRAHJES BUXHETORE SEKTORIALE NGA BE			
Kategoria e parë e vlerësimit			
Kategoria e dokumenteve	I plotesojne standardet	Nuk i plotesojne standardet	Totali
<b>Koncept dokument</b>	09	0	<b>9</b>
<b>Draft ligj</b>	04	11	<b>15</b>
<b>Strategji</b>	01	5	<b>6</b>
<b>Program</b>	4	1	<b>5</b>
<b>Totali</b>	<b>18</b>	<b>17</b>	<b>35</b>

<sup>2</sup> Kategoria e parë e dokumenteve në tabelën e dokumenteve në Shtojcë janë hijezuar me ngjyrë të kaltër.



Sipas tabelës me lartë gjatë kësaj periudhe janë konsultuar gjithsejtë 9 koncept dokumente (të gjitha i plotësojnë standardet); 15 projekt ligje (4 nga të cilat i kanë plotësuar standardet); 6 strategji (1 nga to i ka plotësuar standardet) dhe 5 programe (4 nga të cilat gjithashtu i plotësojnë standardet). Gjithsejta nga 35 dokumente të cilat hyjnë në këtë kategori, 18 prej tyre ose 51 % i kanë plotësuar standardet ndërsa 17 apo 49% prej tyre nuk i kanë plotësuar standardet (shih

Tabela 1 dhe Figura 1)




Figura 6: Shkalla e plotësimit të SBS (me vendime)

2. Grupi i dytë i dokumenteve të cilat hyjnë në vlerësim të gjitha dokumentet për të cilat është mbyllur konsultimi nga data 1 janar deri 31 dhjetor 2019. Për këto dokumente nuk llogaritet kriteri i miratimit të tyre në Qeveri.

Në kuadër të kornizës së kushteve të treguesit të SBS-it gjatë vitit 2019 janë konsultuar gjithsejtë 57 dokumente.


Tabela 2: Përlllogaritja e treguesve të përkrahjes buxhetore sektoriale nga BE. Kategoria e dytë e vlerësimit

PERLLOGARITJA E TREGUESVE TE PERKRAHJES BUXHETORE SEKTORIALE NGA BE			
Kategoria e dytë e vlerësimit			
Kategoria e dokumenteve	I plotësojnë standardet	Nuk i plotësojnë standardet	Totali
<b>Koncept dokument</b>	12	03	<b>15</b>
<b>Draft ligj</b>	25	06	<b>31</b>

<b>Strategji</b>	05	01	<b>6</b>
<b>Program</b>	05	0	<b>5</b>
<b>Totali</b>	<b>47</b>	<b>10</b>	<b>57</b>

Sipas tabelës 2 si më lart, gjatë kësaj periudhe janë konsultuar gjithsejtë 15 koncept dokumente (12 nga të cilat i plotësojnë standardet): 31 projekt ligje (25 nga të cilat i plotësojnë standardet); 6 strategji (5 nga të cilat i plotësojnë standardet) dhe 5 programe (nga të cilat 5 i plotëson standardet). Gjithsej nga 57 dokumente të cilat hyjnë në këtë kategori 47 prej tyre ose 82% i kanë plotësuar standardet ndërsa 10 apo 18% prej tyre nuk i kanë plotësuar standardet (shih Tabela 2 dhe Figura 3).

Figura 7: Shkalla e plotësimit të standardeve të SBS (pa vendime të Qeverisë)



## 10. Metodatat e përdorura gjatë procesit të konsultimeve

Sipas informatave të raportuara nga ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit dhe ato të nxjerra nga Platforma elektronike e konsultimeve publike të gjitha dokumentet e konsultuara gjatë vitit 2019 janë publikuar në platformë. Përveç publikimit në platformë, 103 dokumente (apo 37% të numrit të përgjithshëm të dokumenteve të konsultuara) janë konsultuar edhe përmes punëtorive, ndërsa 99 dokumente apo 36% janë konsultuar përmes e-mailit. Përveç kësaj gjithashtu 35 dokumente apo 12.6% janë konsultuar edhe përmes takimeve publike, 24 dokumente apo 8.6% janë konsultuar edhe përmes takimit sy më sy dhe 21 dokumente po 7.6% janë konsultuar përmes takimeve me grupe të interesit. Metodatat tjera si konferencat, hulumtimet e opinionit, etj. nuk janë

përdorur apo ministritë nuk i kanë raportuar se janë përdorur (tabela nr. 2).

Institucionet të cilat kanë përdorur më së shumti metoda të konsultimeve janë MTI dhe MASHT-MD-i të cilat përveç publikimit në platformë ka përdorur edhe konsultimin me shkrim, takime publike, takime sy më sy takime me grupe të interesi, dhe punëtori. Gjithashtu metoda të ndryshme të konsultimit përveç publikimit në platformë kanë përdorur ZKM, ka përdorur 4 metoda, MAPL dhe MBPZHR nga 3 metoda të konsultimeve, dy metoda të konsultimit kanë përdorur MF, MAP, MSH, MPB, dhe MMPH, MZHE, ndërsa ministritë tjera kanë përdorur vetëm një metodë, gjegjësisht platformën elektronike të konsultimeve ( tabela nr. 4).


*Tabela 3: Metodat e konsultimit të përdorura sipas ministrive*

	Konsultime me shkrim	Platforma	Takime publike	Takime me grupe të interesi	Punëtori	Intervista/takime sy me sy	Numri i metoda ve të përdorura
MAP	0	21	3	0	0	0	2
ZKM	3	11	22	0	3	0	4
MKRS	0	8	0	0	0	0	0
MIT	0	2	0	0	0	0	0
MTI	21	21	0	21	21	21	5
MAPL	5	5	0	5	0	0	3
MM	0	22	0	0	0	0	1
MF	19	19	0	0	0	0	2
MSH	12	12	0	0	0	0	2
MBZHRD	9	9	0	0	9	0	3
MPMS	0	10	0	0	0	0	0
MZHE	0	25	0	0	0	0	1
MD	20	20	1	0	4	2	5
MKK	0	0	0	0	0	0	0
MPB	0	24	0	0	21	0	2
MeD	0	2	0	0	0	0	0
MASHT	10	29	7	0	16	1	5
MPJ	0	4	0	0	0	0	0
MIE	0	1	0	0	0	0	1
MMPH	0	29	0	0	29	0	2

MZHR	0	1	0	0	0	0	0
MIN	0	1	0	0	0	0	1
<b>Totali</b>	<b>99</b>	<b>276</b>	<b>38</b>	<b>21</b>	<b>103</b>	<b>24</b>	<b>0</b>

Shumica e metodave konsultimit të raportuara përmes formularëve, gjithashtu paraqiten edhe përmes përgjigjes së anketës së zhvilluar më koordinatorët e ministrive. Në pyetjen se “*Cilat metoda të konsultimit i konsideroni më të dobishme?*” përgjigja është se platforma elektronike përdoret nga 12 nga 14 resopondent, e-maili përdoret nga 9, punëtoritë nga 12 respondent, takimet sy me sy nga 8 respondent dhe konferencat nga 8 respondent (shih figurën 8).

Figure 8: *Cilat metoda të konsultimit i konsideroni më të dobishme?*



Megjithatë, mbajtja e konferencave si metodë e konsultimit nuk figuron në raportet e ministrive, metodë e cila theksohet se është përdorur nga ana e 8 respondenteve nga 14 sa janë përgjigjur gjithsejtë (ose nga 57% e respondentëve), siç paraqitet në figurën 7.


## 11. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në proces të konsultimeve

Shkalla e pjesëmarrjes së publikut në proces të konsultimeve publike ka shënuar rritje përmbajtësore në krahasim me vitin paraprak. Gjatë vitit 2019 gjithsejtë raportohet se kanë marrë pjesë në procesin e konsultimeve gjithsejtë 3577 pjesëmarrës. Kjo paraqet një rritje prej 143% në krahasim me vitin paraprak, kur në konsultime janë raportuar se kanë marrë pjesë 1469 pjesëmarrës. Megjithëse numri i pjesëmarrësve është rritur, shkalla e kontributit apo komenteve të dhëna gjatë vitit 2019 ka shënuar rënje në raport me vitin paraprak për 30% (nga 1930 në vitin 2018 në 1339 në vitin 2019).

Mënyra e informimit për publikimin e dokumenteve dhe qasjes ndaj palëve të interesit sidomos gjatë procesit të konsultimit ka rëndësi dhe ndikon edhe në kualitetin e kontributit dhe numrin e komenteve.

Në pyetjen se “*Si i informoni palët e interesuara për konsultimet që hapen nga ministria e juaj?*” si pjesë e anketës me koordinatorët e konsultimeve shumica apo 11 nga 14 respondent theksojnë se palët informohen me e-mail për dokumentet që publikohen në platformë apo dalin në konsultim me publikun ndërsa 7 nga respondentet theksojnë se abonentët informohen përmes platformës në mënyrë automatike, 3 nga respondentet theksojnë se palët informohen vetë në platformë, ndërsa 3 të tjerë theksojnë se informohen qoftë me telefon, konferenca apo takime (shih figurën 9).


Figure 9: *Si i informoni palët e interesuara për konsultimet që hapen nga ministria e juaj?*



## 12. Numri dhe statusi i komenteve


Gjatë vitit 2019 nga 276 dokumente të cilat kanë kaluar në proces të konsultimit, numri i përgjithshëm i komenteve të pranuar është 1339. Sa i përket statusit të komenteve llogaritet se 688 ose 61% e tyre janë pranuar nga institucionet hartuese, 97 apo 7.2% prej tyre janë pranuar pjesërisht ndërsa 543 komente apo 4.50% janë refuzuar, ndërsa për 6 komente nuk ka informata nëse janë pranuar apo refuzuar (shih figurën 9).

Figure 10: Numri dhe statusi komenteve (2019)




Sipas numrit të dokumenteve vetëm 27 apo 10% e dokumenteve të publikuara në platformë kanë marrë komente ndërsa 247 apo 90% e dokumenteve nuk e kanë marrur asnjë koment në platformë (figura 11).

Figure 11: Ndarja e dokumenteve sipas komenteve ne platforme




Platforma e konsultimeve publike në versionin aktual mund të gjenerojë vetëm numrin e komentuesve dhe numrin e dokumenteve të cilat janë komentuar përmes platformës por jo edhe numrin e komenteve. Shumë nga komentet në platformë janë ofruar përmes dokumenteve të bashkëngjitura të cilat në një dokument përmbajnë një numër më të madh të komenteve sesa ato që gjenerohen automatikisht në seksionin e statistikave. Një problem tjetër i hasur gjatë hartimit të raportit është edhe pamundësia e ndarjes së numrit të komenteve të ofruara përmes platformës dhe ato që janë ofruar përmes metodave tjera, për arsye se një informatë e tillë nuk është ofruar përmes raporteve të të konsultimeve të publikuara në platformë. Ndërsa numri i komenteve të llogaritura në këtë raport bazohet në informatat zyrtare të ofruara nga ana e koordinatoreve të konsultimeve publike në ministri (figura 12).

Figure 12: Komentet sipas ministrive



Në grafikun në vazhdim pasqyrohen informatat krahasuese sipas ministrive për numrin e dokumenteve të konsultuara, numrit të pjesëmarrësve dhe numri i komenteve. Vlen të theksohet se pjesëmarrja e publikut në procesin e konsultimeve sipas të dhënave ndryshon nga ministria në ministri. Statistikat e pjesëmarrjes, numrit të dokumenteve të konsultuara si dhe numrit të komenteve në shumicën e rasteve janë jo proporcionale me njëra tjetrën (Fig. nr. 13).

Figure 13: Dokumente të konsultuara, pjesëmarrës dhe komente



### 13. Statistikat krahasuese mes viteve 2017, 2018 dhe 2019

Volumi i aktiviteteve të ministrive për procesin e konsultimit gjatë vitit 2019 nuk dallon shumë nga viti paraprak. Qëllimi kryesor gjatë vitit 2019 ka qenë përfshirja e të gjitha dokumenteve në proces të konsultimit, rritja e numrit të dokumenteve që i plotësojnë standardet dhe përmirësimi i cilësisë së konsultimeve.


**Përfshirja e dokumenteve në konsultime** – Trendi i rritjes së numrit të dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2019 është pozitiv në krahasim me vitet e mëparshme. Numri i përgjithshëm i dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2019 është 18% më i lartë apo 46 dokumente më shumë sesa 2018, ndërsa 21% apo 53 dokumente më shumë sesa viti 2017 (viti 2017: 221, viti 2018: 228 dokumente, viti 2019: 274 dokumente). Gjithashtu duhet të ceket se gjatë vitit 2019 nuk kemi ndonjë dokument që nuk ka kaluar procesin e konsultimit.

**Shkalla e plotësimit të standardeve** – Shkalla e plotësimit të standardeve në krahasim me vitin paraprak gjatë vitit 2019 ka shënuar një rritje prej 5% në krahasim me vitin 2018. Në shifra numri i dokumenteve që i plotësojnë standardet gjatë vitit ishte 2019 ishte 168, gjatë vitit 2018 ky numër ishte 127, ndërsa gjatë vitit 2017 numri i dokumenteve që kanë plotësuar standardet ishte 116.

Gjatë vitit 2019 standardet nuk i kanë plotësuar 106 dokumente të konsultuara, gjatë vitit 2018, standardet nuk i kanë plotësuar 101 dokumente ndërsa gjatë vitit 2017 nuk i kanë plotësuar standardet 105 dokumente (figura 14).



Figura 14: Informatat krahasuese 2017-2018-2019



